



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201801725/9

Tiranë ____/____/2019

Lënda : Marrja e masave për kthimin e menjëhershëm të sendit provë materiale të sekuestruar shtetasit, A. Gj., një aparat celular i markës "Samsung GT-N7000, në zbatim të vendimit nr.859.Akti, datë 27.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë".

Drejtuar: Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor
Znj. Elisabeta YMERI

Tiranë

E nderuar Znj.YMERI,

Më datë 10.09.2018, shtetasi A. S. Gj., nga Tirana, i është drejtuar me ankesë Institucionit të Avokatit të Popullit, në të cilën ka ngritur shqetësimin dhe ankohet ndaj Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pasi nuk i ka kthyer sendin e sekuestruar, një aparat celular i markës "Samsung GT-N7000, me ngjyrë të zezë me numer IMEI 351823055452932.

Në ankesë shtetasi A. Gj., sqaron se në vitin 2015, ka qënë i pandehur në një çështje penale nën akuzën e "Ngacmimit seksual", "Përndjekjes" dhe të "Largimit të burgosurit nga vëndi i qëndrimit". Hetimet e kësaj çështje janë kryer nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me prokuror z. A. C. (Shkarkuar nga detyra prej Komisionit të Vetingut)

Gjatë hetimit dhe konkretisht më datë 24.06.2015, nga Policia Gjyqësore është mbajtur një proces verbal mbi sekuestrimin e sendit provë materiale siç është dhe aparati celular me karakteristikat e përshkruara më lart. (bashkëlidhur kopje e proces verbalit të sekuestrimit të sendit).

Nga studimi i vendimit të marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.2126 datë 27.06.2016, konstatohet se ajo nuk është shprehur në dispozitivin e vendimit për disponimin e sendit provë materiale të sekuestruar nga organi i prokurorisë, i cili si gjatë fazës së hetimit të procedimit penal deri në përfundimin e tij dhe dërgimin e çështjes në gjyq, nuk i ka kthyer sendin e sekuestruar, sipas pikës 2 të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale.

Në këto rrethana shtetasi A. Gj., më datë 08.01.2018, i është drejtuar me kërkesë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të cilën e ka përsëritur më datë 10.09.2018 (bashkëlidhur kopje e kërkesave).

Mbi shqetësimin e z. Gj., më datë 14.09.2018, me shkresën nr.K2/A87-3, i kemi kërkuar informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila më datë 02.10.2018, me shkresën nr.13305/1, (bashkëlidhur kopje e shkresës) informon Institucionin e Avokatit të Popullit, duke vënë dijeni dhe ankuesin A. Gj., se:

“Me vendimin nr.2126 datë 27.06.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shtetasi A. Gj., është deklaruar fajtor për veprën penale të “Ngacmimit seksual”, “Përndjekjes” dhe “Largim i të burgosurit nga vëndi i qëndrimit” dhe është dënuar përfundimisht me 1 vit e 8 muaj burgim, dënim të cilin e ka vuajtur.

Në vendimin e mësipërm gjykata nuk ka disponuar dhe nuk është shprehur mbi provën materiale, aparatën celular të sekuestruar shtetasit të mësipërm në fazën e hetimeve paraprake. Në këto rrethana, referuar kërkesave të Kodit të Procedurës Penale, shtetasi i mësipërm duhet t’i drejtohet gjykatës, me kërkesë për kthimin e sendit të sekuestruar”.

Duke konstatuar se përgjigja e Prokurorisë nuk i jepte zgjidhje ankesës së shtetasit A. Gj., më datë 08.05.2019, me shkresën nr.K2/A87-10, i kemi kërkuar informacion shtesë, për të sqaruar nëse prokurori i çështjes i ka kërkuar informacion kompanive celulare për tabulatet telefonike në aparatën celular të sekuestruar, nëse aparati celular i sekuestruar nga Policia Gjyqësore është rregjistruar në rregjistrin e provave materiale që disponon ai organ dhe më pas, prokurori në shkresën përcjellë të vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq ka përshkruar dhe përcjellë sendin provë materiale pranë asaj gjykate.

Më datë 22.05.2019, me shkresën nr.510/2 (bashkëlidhur kopje e shkresës) informon ndërmjet të tjerave institucionin e Avokatit të Popullit se: *“...nga verifikimet e bëra në sekretarinë e prokurorisë dhe në dosjen nr.5373 të vitit 2015, si dhe i rregjistrimit të provave materiale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nuk rezulton që të jetë rregjistruar prova materiale e sekuestruar në procesverbalin e datës 24.06.2015, nga oficeri i Policisë Gjyqësore R. L.,”.*

Nga analiza e ankesës së qytetarit A. Gj., aktet e administruara dhe përgjigjet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, arrijmë në disa konstatime dhe përfundime:

Së pari: Në moskuptimin dhe konceptimin e drejtë për objektin e sekuestrimit, i cili është i lidhur ngushtë me kuptimin e provës materiale, neni 187 i Kodit të Procedurës Penale, dhe sendeve që lidhen me veprën penale.

Sekuestrimi është një nga mjetet e rëndësishme të kërkimit të provës, me anë të së cilit realizohet kufizimi i përkohshëm, deri në një vendim përfundimtar të prokurorit ose

gjykatës, i të drejtave pasurore të një personi mbi një send të caktuar, nëpërmjet marrjes së tij ose nëpërmjet detyrimit për të mos i ushtruar të drejtat kur sendi nuk mund të merret. Ligjshmëria në kryerjen e sekuestrimit është e lidhur ngushtë me respektimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për kryerjen e tij.

Së dyti: Në mos respektimin me korrektësi të dispozitave procedurale, për sekuestrimet dhe disponimin e sendeve prova materiale të sekuestruara.

Këto dispozita parashikojnë detyrimin e organit procedues për nxjerrjen e urdhërit për kthimin e sendeve prova materiale, të sekuestruara dhe më pas, ndjekjen me qëllim zbatimi të urdhërit.

Kjo për faktin se në nenin 190/1 “ç” i Kodit të Procedurës Penale, Disponimi për provat materiale, përcaktohet se prokurori në vendimin që merr cakton se çfarë duhet të bëhet me provat materiale duke urdhëruar, *“kthimin e sendeve personave që u takojnë, dhe kur ka konflikt për pronësinë e tyre, ruhen gjersa ai të zgjidhet nga gjykata”*.

Në nenin 217 të Kodit të Procedurës Penale thuhet: *“Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestros për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar. Kur është e nevojshme, organi procedues urdhëron të sillen sendet e kthyer”*.

Në nenin 218/3 të Kodit të Procedurës Penale thuhet: *“Gjatë hetimeve paraprake, kthimi i sendeve të sekuestruara urdhërohet nga prokurori. Kundër këtij urdhëri të interesuarit mund të bëjnë ankim në gjykatë”*.

Së treti: Në detyrimin ligjor të prokurorit, për të zbatuar vendimet e gjykatës për kthimin e sendit provë materiale, të sekuestruar.

Në nenin 1 të Ligji nr.8331 datë 21.4.1998, “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale” i ndryshuar thuhet: *“Ky ligj ka për objekt vënien në ekzekutim të vendimeve penale dhe urdhërimeve të tjera ligjore...”*. Kurse në nenin 8, të ligjit, Përgjegjësia e Organeve të Ekzekutimit, thuhet: *“Organet dhe punonjësit që ekzekutojnë vendimet sipas këtij ligji janë të detyruar të ushtrojnë me korrektësi kompetencat, duke respektuar të drejtat, nderin dhe dinjitetin e personit”*.

Ndërsa në nenin 463 të Kodit të Procedurës Penale, Veprimet e Prokurorit, thuhet: *“Prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, merr masa për ekzekutimin e vendimit....”*.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.akti 859, datë 27.12.2018 (i cili ka marrë formë të prerë) me pjesëmarrjen e prokurores znj. Eriselda Bala, ka pranuar kërkesën e z. A. Gj., për kthimin e sendit të sekuestruar duke cituar: *“Në kushtet kur sendi i kërkuesit nuk i është kthyer efektivisht atij, rezulton që t’i jetë sekuestruar kërkuesit dhe të jetë në përkatësi të tij, si dhe vijon të jetë pjesë e dosjes gjyqësore, e nuk ka asnjë pengesë ligjore për disponimin e tij. Gjykata bazuar në nenet 217,218 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, konkludon që për sa u argumentua kërkesa e kërkuesit duhet të pranohet si e bazuar në prova e në ligj dhe duhet t’i kthehet sendi i sekuestruar”*.

Më datë 14.02.2019, shtetasi A. Gj., i ka dërguar kërkesë Gjykatës Penale të Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt ekzekutimin e vendimit gjyqësor për kthimin e sendit të sekuestruar por nuk ka marrë asnjë përgjigje (bashkëlidhur kopje e shkresës)

Vërehet zvarritje e pajustificuar e procedurave nga momenti i sekuestrimit të sendit provë materiale në pronësi të shtetasit A. Gj., ndërkohë kur kanë kaluar pesë muaj nga koha që vendimi i gjykatës për kthimin e tij ka marrë formë të prerë. Mosmarrja e masave nga ana e prokurorit për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, kanë sjellë për pasojë cënimin e të drejtës pasurore mbi sendin që disponon qytetari, apo mospërdorimin e aparatit celular për nevojat e tij vetiake.

Së katërti: Asnjë përpjekje e organit të Prokurorisë për të verifikuar e më pas për të hetuar, lidhur me fatin e sendit provë materiale, sekuestruar nga Policia Gjyqësore.

Ndodhemi para faktit të pranuar dhe nga organi i prokurorisë se sendi i sekuestruar nga Policia Gjyqësore, në pronësi të shtetasit A. Gj., nuk figuron i regjistruar në regjistrat e provave materiale që disponon. Për rrjedhojë do të sugjerim verifikimin dhe hetimin e rastit, si e vetmja rrugë ligjore për të vënë në vënd të drejtën që i është shkelur qytetarit, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës që kanë kryer veprimin e kundërligjshëm.

Sa më sipër duke gjetur se ankesa e z.Arben Gjoka është e drejtë, bazuar në nenin 21 shkronja “c” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, ku thuhet: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”.

REKOMANDOHET

“Marrja e masave për kthimin e menjëhershëm të sendit provë materiale të sekuestruar shtetasit A. Gj., një aparat celular i markës “Samsung GT-N7000, në zbatim të vendimit nr.859 Akti, datë 27.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Mbi masat e marra në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na dërgoni përgjigje brënda 30 ditëve, parashikuar nga neni 22 i ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.

K O M I S I O N E R I

Ermonela RUSPI